



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BAsENIT UJOR VJOSË

Nr. 6/6 prot.

VENDIM

Norë, më 13.05.2024

Nr. 5, datë 02/05/2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIMI TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME TË NDRYSHME, TË SHOQËRISË “ELKA-SA” SH.A, ME VENDNDODHJE: FSHATI VRISERA, BASHKIA DROPULL, QARKU GJIROKASTËR.

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzimi të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme, të shoqërisë “ELKA-SA” sh.a, me vendndodhje: Fshati Vrisera, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH):

X=529196.98;

Y=4418652.63;

Z=290 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime sanitare

Prurja e ujit të kërkuar: $Q=0.12$ l/sek

Thellësia e pompës: 20m

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

$X=529114.18$; $Y=4418785.30$; $Z=287$ m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q=0.11$ l/sek

Trupi ujqor pritës: Lumi i Kseries-Drinos

Përpara derdhjes në trupin ujqor pritës (Lumi i Kseries-Drinos) uji i shkarkuar duhet të jetë brenda parametrave të VKM-së Nr.177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujqore pritëse".

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU VJOSË

VANGJEL TAVO

